

Burimet: deklarata E.H, FDH-13001; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Skender (Brahim) Koca

(20.10.1962, shqiptar nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, tre fëmijë)

Skenderi me familje e kanë braktisur fshatin [Polac/Poljance] më 22.09.1998. Shkuan me traktor deri te pyjet e fshatit **Kozhicë/Kožica**, në vendin e quajtur *Fusha e Mollës/Jabukovo polje* [bjeshka e **Çiçavicës/Čičavica**]. Atje gjendej një numër i madh refugjatësh nga fshatrat përreth. Forcat serbe e bombardonin pyllin pa pushim. Ditën e nesërme, më **23.09.1998**, vazhduan bombardimet dhe të shtënat. Skenderi me vëllain Naimin vendosën të tërhiqeshin në thellësi të pyllit. Atje u takuan me disa të afërm dhe burra të tjerë, që po ashtu ishin tërhequr më thellë në mal. Në çastin kur u ndalën për të pushuar, të shtënat u intensifikuan dhe filluan t'i afroreshin vendit ku gjendeshin ata. Në tollovinë dhe panikun e krijuar, Skenderi u nda nga Naimi. Në mbrëmje, pas tërheqjes së forcave serbe, Naimi u nis ta gjente të vëllain, por nuk e gjeti te vendi ku u ndanë. Katër ditë më vonë, kushëriri i tyre Musa ka mësuar se në pyll gjendej trup i një burri të vrrarë. Ai dhe Naimi shkuan atje dhe konstatuan se bëhej fjalë për Skenderin. E kishin qëlluar me plumba në kokë dhe gjoks. Familjarët e kanë varrosur Skenderin më 1.10.1998 në varrezat e *Mëhallës Koca* në Polac/Poljance.

Burimet: deklarata N.K, FDH-13676; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Arsim (Arif) Shabani

(22.07.1972, shqiptar nga Kozhica/Kožica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, tre fëmijë)

Arsimi me familje jetonin në *Mëhallën Shabani* në **Kozhicë/Kožica**. Në datën 22.09.1998, ata i strehuan refugjatë nga fshatrat përreth. Të nesërmen, më **23.09.1998**, kur forcat serbe e sulmuan

Kozhicën/Kožica, Arsimi me familjarët dhe refugjatët e braktisën fshatin dhe u strehuan në bjeshkën e **Çiçavicës/Čičavica**. Arsimi rrinte i ulur pranë një peme duke e mbajtur në prehër vëllain e vogël Meritonin, kur disa predha ranë në afërsi të tij, Arsimi u qëllua për vdekje, ndërkaq Meritoni i vogël vetëm u plagos. Bashkëshortja e Arsimit, Miradija, e ka marrë djalin e plagosur, e ka mbuluar Arsimin me batanije dhe me refugjatë të tjerë vazhduan të raponin duke kërkuar strehim të sigurt. Një ditë më vonë, familjarët e kanë marrë trupin e Arsimit dhe e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata M.S, FDH-14928; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Arjanit (Asllan) Rama

(16.07.1996, shqiptar nga Turiqeci/Turićevac, komuna e Skënderajt/Srbica)

Arjaniti ka qenë më i ri nga nëntë fëmijët e Asllanit dhe të Bahtijes. Qe nga fillimi i muajit shtator të vitit 1998, e gjithë familja e ka braktisur Turiqecin/Turićevac dhe ka kaluar në Baks. Atje qëndruan deri më 21.09.1998, kur në fshat u dislokuan forcat serbe. Atëherë, me banorë të tjerë, u zhvendosën në bjeshkën e **Çiçavicës/Čičavica**, në pyll përmbi fshatin **Kozhicë/Kožica**. Kur forcat serbe e nisën më **23.09.1998** bombardimin e pyllit, Bahtija dhe Asllani u nisën që ta kërkonin ndonjë strehim më të mirë për fëmijet. Në çastin kur Arjaniti mbeti vetëm, një granatë eksplodoi pranë tij. Ciflat e saj e qëlluan në kokë dhe në trup. Ka dhënë shpirt në vend. Bahtija e ka mbajtur ngrënë trupin e të birit të vrrarë deri në mbrëmje, kur e varrosën në varrezat e Qirezit/Čirez, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata B.R, FDH-17298; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Shqipdon (Xhevdet) Xani

(3.07.1998, shqoptar nga Dasheci/Doševac, komuna e Skënderajt/Srbica)

Bedrija dhe Xhevdeti i kishin dy djemtë,